



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Datë: 01.10.2025

Numër Protokolli: 6560/2025

A.nr.1556/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Eshref Shabani, kryetar Ardita Haxhnikaj Demi dhe Malsore Gashi Bajraktari, anëtarë, me Rushit Kajtazi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.1556/2025, të datës 07.08.2025, të parashtruar nga ankuesi V.H, kundër organit të punësimit/Inspektorati i Punës, në çështjen juridike “kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafi 1, nën paragrafi, 1.1 dhe nenin 18, paragrafi 1, nën paragrafin 1.2, të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 01.10.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa A.nr.1556/2025, e datës 07.08.2025, e parashtruar nga ankuesi V.H.

II. Anulohet në tersi procedura e pranimit sipas konkursit me Nr. Reference: RN00017327 për Grupi i Administrim të Përgjithshëm, pozita e punës ‘Inspektor për Siguri dhe Shëndet në Punës në Divizionin për Inspektim në Rajonin e Gjakovës’, i shpallur nga Inspektorati i Punës, si dhe çdo veprim tjetër i rrjedhë nga kjo procedurë,

III. Obligohet Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore e Inspektoratit i Punës, që të bëjë zbatimin e këtij vendimi, brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të tij, duke ndërmarr të gjitha veprimet si në pikën II të dispozitivit.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim për veprimet e ndërmarra.

A r s y e t i m

Kandidati për pranim në shërbimin civil, V.H, (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi), me datë 07.08.2025, ka parashtruar ankesë për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Njoftimit për kandidatin fitues të datës 08.07.2025, të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, lidhur me konkursin me Nr. Reference RN00017327, për Grupi Administrim i

Përgjithshëm, pozita e punës “Inspektor për Siguri dhe Shëndet në Punë në Divizionin për Inspektim në Rajonin e Gjakovës”, i shpallur nga Inspektorati i Punës, *(tani e tutje referuar IP)*.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës *(në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli)* bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, e ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek IP, ndërsa kjo e fundit me datë 05.09.2025, ka dorëzuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) për vendosje meritore administroi këto prova Ankesën me numër protokolli 5282/2025, të datës 07.08.2025, të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Konkursin RN00017327 për Inspektor për Siguri dhe Shëndet në punës në Divizionin e Inspektimit në Rajonin e Gjakovës; Vendimi me numër protokolli 962, i datës 08.05.2025; Njoftimi me numër protokolli 1089, i datës 23.05.2025, i nxjerr nga Divizioni i Burimeve Njerëzore Inspektorati Qendror i Punës; Kopje e letërnjoftimit për V.H; Përgjigjen në ankesë me numër protokolli 1556/2025, të datës 05.09.2025; Aplikacioni i V.H, me shkresat e bashkangjitura; Diplomë me numër protokolli 5628, të datës 05.11.2017, për V.H, e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”; Diplomë me numër protokolli 1497, të datës 14.09.2020, për V.H, e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”; Letër referencë e datës 08.04.2020; Pasqyra e trustit për V.H, për periudhën nga data 17.08.2017, deri me datën 10.04.2025; Formuari i Vlerësimit Individual të Anëtarit të Komisionit për kandidatin në Intervistë, për V.H, nga anëtari i komisionit Gj.Q; Formuari i Vlerësimit Individual të Anëtarit të Komisionit për kandidatin në Intervistë, për V.H, nga anëtari i komisionit v.zh; Formuari i Vlerësimit Individual të Anëtarit të Komisionit për kandidatin në Intervistë, për V.H, nga anëtari i komisionit L.J; Formuari i Vlerësimit Individual të Anëtarit të Komisionit për kandidatin në Intervistë, për V.H, nga anëtari i komisionit L.B; Përshkrimi i detyrave të punës Inspektor për Siguri dhe shëndet në Punë; Testi me shkrim për V.H; Akt Emërimi i datës 06.06.2019, për V.Zh; Akt Emërimi i datës 01.07.2016, për L.B; Akt Emërimi i datës 01.01.2012, për Gj.Q; Vendimi me numër protokolli 844, i datës 23.04.2025; Akt Emërimi i datës 08.09.2023, për B.B; Akt Emërimi i datës 01.06.2023, për L.J; Vendimin me numër protokolli 612 të datës 21.03.2025 për shpalljen e konkurseve; Vendimin me numër protokolli 1104 të datës 29.05.2025 për themelimin e komisionit të pranimit; Lista e Aplikantëve; Njoftimi i datës 08.07.2025; Aplikacioni i Z.B, me shkresat e bashkangjitura; Diplomë me numër protokolli 7442, të datës 07.04.2021, për Z.H, e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”; Certifikatën e datës 31.03.2023; Vërtetimi i datës 08.04.2025; Kontratë e datës 26.03.2024; Pasqyra e trustit për Z.B, për periudhën nga data 15.01.2024, deri me datën 16.09.2024; Kopje e letërnjoftimit për Z.B; Aplikacioni i A.B, me shkresat e bashkangjitura; Diplomë me numër protokolli 553, të datës 04.02.2015, për A.B, e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës; Diplomë me numër protokolli 1217, të datës 27.09.2021, për A.B, e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”; certifikatat për A.B; Vërtetimi i datës 12.08.2021; Vërtetim i datës 18.02.2020; ; Pasqyra e trustit për A.B, për periudhën nga data 16.01.2019, deri me datën 25.09.2024; Letër referencë e datës 03.03.2025; Rekomandim; Kopje e letërnjoftimit për A.B; Vërtetimi i marrëdhënies së punës i datës 02.10.2024; Pasqyra e trustit për A.B, për periudhën nga data 16.01.2019, deri me datën 10.04.2025 Vërtetim i datës 05.02.2025; Aplikacioni i C.A, me shkresat e bashkangjitura; Diplomë me numër protokolli 1311/13, të datës 27.10.2016, për Ç.A e lëshuar nga Kolegji AAB; Pasqyra e trustit për Ç.A, për periudhën nga data 05.03.2011, deri me datën 20.03.2025; Referencë e datës 10.02.2019; Kopje e letërnjoftime për Ç.A; Pasqyra e trusti për Ç.A, për periudhën nga data 01.01.2024, deri me datën 08.07.2024; Formuari i Vlerësimit Individual të Anëtarit të Komisionit për kandidatin në Intervistë, për A.B, nga anëtari i komisionit B.B; Formuari i Vlerësimit Individual të Anëtarit të Komisionit për kandidatin në Intervistë, për Z.B, nga anëtari i komisionit B.B; Formuari i Vlerësimit Individual të Anëtarit të Komisionit për kandidatin në Intervistë, për Ç.A, nga anëtari i komisionit Gj. Q; Formuari i Vlerësimit Individual të Anëtarit të Komisionit për kandidatin në Intervistë, për Z.B, nga anëtari i

komisionit Gj.Q; Formuari i Vlerësimit Individual të Anëtarit të Komisionit për kandidatin në Intervistë, për A.B, nga anëtari i komisionit Gj.Q; Formuari i Vlerësimit Individual të Anëtarit të Komisionit për kandidatin në Intervistë, për Ç.A, nga anëtari i komisionit V.Zh; Formuari i Vlerësimit Individual të Anëtarit të Komisionit për kandidatin në Intervistë, për A.B, nga anëtari i komisionit V.Zh ; Formuari i Vlerësimit Individual të Anëtarit të Komisionit për kandidatin në Intervistë, për Z.B, nga anëtari i komisionit L.J; Formuari i Vlerësimit Individual të Anëtarit të Komisionit për kandidatin në Intervistë, për Ç.A, nga anëtari i komisionit L.J; Formuari i Vlerësimit Individual të Anëtarit të Komisionit për kandidatin në Intervistë, për A.B, nga anëtari i komisionit L.J; Formuari i Vlerësimit Individual të Anëtarit të Komisionit për kandidatin në Intervistë, për A.B, nga anëtari i komisionit L.B; Testi me shkrim për T.K; Testi me shkrim Sh.P.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, konstatoi së ankesa e ankuesit **është e bazuar**, sepse:

Nga administrimi i shkresave të lëndës, Kolegji i Këshillit, ka konstatuar se Inspektorati i Punës, më datë 21.03.2025 ka shpallur konkursin me Nr. Reference: RN00017327, për pozitën e punës “Grupi i Administrim të Përgjithshëm, pozita e punës ‘Inspektor për Siguri dhe Shëndet në Punë në Divizionin për Inspektim në Rajonin e Gjakovës”, numri i kërkuar 3, pozita me afat aplikimi nga data 22.03.2025 deri më datë 20.04.2025.

Tutje, nga shkresat e lëndës rezulton se në këtë konkurs ka aplikuar edhe ankuesi, i cila e ka kaluar fazën e verifikimit paraprak dhe i është nënshtruar testimit me shkrim si dhe intervistës me gojë, ndërsa sipas Njoftimit të datës 08.07.2025 për vlerësimin përfundimtar të kandidatëve, pas kryerjes së procedurave të rekrutimit, rezulton se kandidatët që ka marrë pikë më së shumti është kandidati A.B me gjithsejtë 87 pikë, kandidatja Z.B, me gjithsejtë 84.6 pikë, dhe kandidati Ç.A, me gjithsejtë 75.4 pikë dhe rezulton të jenë si kandidat të suksesshëm në procedurë.

Kolegji i Këshillit mbështetur në mandatin kushtetues dhe ligjor lidhur me sigurimin e respektimit të rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil, e ndërlidhur me nenin 86 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se: *“Organi publik përcakton, në mënyrë të pavarur, llojin dhe shtrirjen e shqyrtimit administrativ, si dhe vlerëson nëse një fakt apo rrethanë është e nevojshme për zgjidhjen e çështjes”*, ka shqyrtuar në kuptim të ligjshmërisë veprimet procedurale të ndërmarra në procedurën e pranimit sipas konkursit Nr. Reference: RN00017327, për pozitën e punës “Inspektor për Siguri dhe Shëndet në Punë në Divizionin për Inspektim në Rajonin Gjakovë”, dhe si rrjedhojë e analizimit të provave materiale ka konstatuar së z. R.P, sipas Vendimit me numër protokolli 701/2025 të datës 06.03.2025 të Ministrit të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve është caktuar ushtrues detyre i Drejtorit Ekzekutiv të Inspektoratit Qendror të Punës. Me tej Vendimi me numër protokolli 701/2025 i datës 06.03.2025 të Ministrit të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve ishte kontestuar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nga A.M, ndërsa Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datë 22.04.2025 kishte nxjerr Vendim A.nr.432/2025 me të cilin kishte aprovuar ankesën e palës ankuese A.M, dhe kishte shfuqizuar Vendimin me numër protokolli 701/2025 të datës 06.03.2025 të Ministrit të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve për caktimin e R.P si ushtrues detyre i Drejtorit Ekzekutiv të Inspektoratit Qendror të Punës, me arsyetimin se caktimi i ushtruesit të detyrës nuk ishte bërë një nga zyrtarët e kategorisë pasuese, e për rrjedhojë këtë vendim e kishte shpallur të paligjshëm.

Kolegji i Këshillit, sipas provave materiale të lëndës, konstaton se z. R.P, në cilësinë e ushtruesit të detyrës së Drejtorit Ekzekutiv të Inspektoratit Qendror të Punës, më datë 21.03.2025 kishte nxjerr Vendimin me numër protokolli 622 me të cilin kishte obliguar Njësinë e Burimeve Njerëzore të Inspektoratit të Punës, që të bëjë shpalljen dhe zhvillimin e procedurave të rekrutimit për pozitat e lira të Inspektoreve për Siguri dhe Shëndet në Punë, në Inspektoratin e Punës respektivisht edhe për pozitën në të cilën ka aplikuar ankuesi “Inspektor për Siguri dhe Shëndet në Punë në Divizionin për Inspektim në Rajonin Gjakovës”, ndërsa kolegji në lidhje me këtë lëndë, ndërlidhur me vendimmarrjen sa i përket kësaj ankese mori për bazë edhe vendimin nr.1104/02 të datës 29.05.2025 mbi themelimin e komisionit të pranimit të nxjerre nga z. R. P. ushtrues detyre i Drejtorit Ekzekutiv të Inspektoratit Qendror të Punës, përmes së cilës provë konfirmohet fakti se përkundër që Këshilli përmes vendimit A.nr.432/2025 të datës 22.04.2025 kishte shfuqizuar vendimin e Ministrit të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, duke konstatuar se caktimi i ushtruesit të detyrës së Drejtorit Ekzekutiv të Inspektoratit Qendror të Punës sipas Vendimit me numër protokolli 701/2025 të datës 06.03.2025 për emërimin e nëpunësit civil *z.R.P nga pozita Zyrtar Shpenzues dhe i Pasurisë* ’’,e cila pozitë është e kategorisë profesionale (Profesional 2) është në kundërshtim me nenin 35 paragrafin 2 të Ligji Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, duke vepruar kështu në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik dhe Ligjin Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, prandaj Vendimi me numër protokolli 701/2025 i datës 06.03.2025 i Ministrit të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve ishte konstatuar si akt administrativ i paligjshëm sikurse përcaktohet me dispozitat e nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3, dhe 1.5 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe si i tillë ishte shfuqizuar sikurse në dispozitiv të vendimit A.nr.432/2025 të datës 22.04.2025.

Ndërsa përkundër që sipas vendimit të këshillit A.nr.432/2025 të datës 22.04.2025 të potencuar si më lartë përmes së cilit ishte shfuqizuar vendimi me numër protokolli 701/2025 i datës 06.03.2025 mbi caktimin e ushtruesit të detyrës së Drejtorit Ekzekutiv të Inspektoratit Qendror të Punës duke konstatuar faktin se caktimi i të njëjtit në këtë pozitë është në kundërshtim me legjislacionin përkatës të zyrtarëve publik, Ministri i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve prapë duke shpërfillur vendimin e këshillit përkatësisht konstatimet që janë nxjerrë në përmbajtje të atij vendimi, prapë më datë 26.05.2025 përmes vendimit nr.701-1/2025 kishte caktuar të njëjtin zyrtarë z.R.P në pozitë të ushtruesit të detyrës së Drejtorit Ekzekutiv të Inspektoratit Qendror të Punës, me që rast edhe ky vendim ishte në kundërshtim me nenin 35 paragrafin 2 të Ligji Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik dhe i cili bazuar në nenin 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3, dhe 1.5 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative nuk mund të prodhojë efekte juridike.

Kolegji i Këshillit ndërlidhur me çështjet e potencuar si më lartë konstaton se ushtruesi i detyrës së Drejtorit Ekzekutiv të Inspektoratit Qendror të Punës, më datë 29.05.2025,kishte themeluar komisionin e pranimit nr.1104/02 për pozitën që atakohet me këtë ankesë përkatësisht konkursin RN00017327,dhe në kuptim të kompetencës dhe autorizimit ligjor për veprim në këtë procedurë, të z. R. P, si ushtrues detyre i Drejtorit Ekzekutiv të Inspektoratit Qendror të Punës, Kolegji i Këshillit vlerëson se i njëjti mbi bazën ligjore të specifikuar si më lartë nuk ka poseduar autorizim ligjor që të ndërmerr veprime në këtë procedurë të pranimit, nga se siç u konstatua edhe më lartë në arsyetim të këtij vendimi, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës përmes Vendimit A.nr.432/2025 të datës 22.04.2025, caktimin e tij ushtrues detyre sipas Vendimit me numër protokolli 701/2025 të datës 06.03.2025 të Ministrit të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve e kishte konsideruar të kundërligjshëm, e për rrjedhojë në çfarëdo rrethane caktimi i z.R.P i cili sipas Akt Emërimit të datës 07.04.2022 mban pozitën Zyrtar Shpenzues dhe i Pasurisë, si ushtrues detyre i Drejtorit Ekzekutiv të Inspektoratit Qendror të Punës cenon parimet e ligjshmërisë dhe dispozitave të nenit 35 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, andaj mbi këto rrethana faktike dhe ligjore Kolegji i Këshillit konstaton se Vendimi me numër protokolli 622 i datës 21.03.2025 dhe vendimi me nr.1104/02 i datës 29.05.2025

mbi themelimin e komisionit të pranimit konsiderohen vendime të marra nga personi që nuk posedon autorizim ligjor sipas nenit 4 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dhe si të tilla janë veprime të paligjshme-nule në kuptim të nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme i cili përcakton se: *“1.Një akt administrativ është i paligjshëm nëse: 1.1. është nxjerrë në mungesë të autorizimit nga një ligj, sipas paragrafit 2 të nenit 4 të këtij Ligji”*.

Nisur nga fakti se sipas Vendimit me numër protokolli 612 të datës 21.03.2025 mbi aprovimin e shpalljeve të konkurseve, vendimit të Ministrit të MFPT-së, Nr.01/02-701-1/2025 të datës 26.05.2025,përmes së cilit kishte caktuar si ushtrues detyre të Drejtorit Ekzekutiv të Inspektoratit Qendror të Punës z.R.P i cili pastaj përmes vendimit nr.1104/02 të datës 29.05.2025 kishte themeluar komisionin e pranimit për këtë pozitë dhe disa pozita tjera, mbi bazën e ligjore të specifikuar si më lartë, janë vendime të paligjshme mbi arsyet e dhëna si më lartë në arsyetim të këtij vendimi, atëherë, çdo veprim tjetër pasues i ndërmarr në procedurat e pranimit sipas konkursit me Nr. Reference: RN00017327, për pozitën e punës “Inspektor për Siguri dhe Shëndet në Punë në Divizionin për Inspektim në Rajonin Gjakovës” cilësohen si veprime të paligjshme dhe nuk prodhojnë pasoja juridike, kështu që, mbi gjendjen e këtyre fakteve dhe konstatimeve , duke përfshi këtu edhe përgjigjen e vetë institucionit të dhënë në lidhje me ankesën A.nr.1556 të datës 07.08.2025,ku kontestohet kjo procedurë e regrutimit, rezulton se procedura e zhvilluar sipas konkursit të cekur më lartë konsiderohen të paligjshme, andaj mbi këtë bazë dhe konstatimeve të dhëna si në arsyetimin e këtij vendimi, gjithnjë duke pasur parasysh edhe faktin se vendimi Nr.01/02-701-1/2025 i datës 26.05.2025 mbi caktimin e z.R.P si ushtrues i detyrës së Drejtorit Ekzekutiv të Inspektoratit Qendror të Punës siç u konstatua më lartë nuk ka mbështetje ligjore dhe po ashtu ishte konstatuar kundërligjshmëria sipas vendimit të këshillit A.nr.432/2025 të datës 22.04.2025,se për shkak të kategorisë i njëjti nuk mund të caktohet ushtrues i detyrës në asnjë rrethanë , ndërsa nga shkresat e lëndës konstatohet se ky vendim mbi caktimin e të njëjtit ushtrues i detyrës së Drejtorit Ekzekutiv të Inspektoratit Qendror të Punës ishte shfuqizuar më datë 16.07.2025 përmes vendimit me numër 11-2/2025,andaj edhe Kolegji i Këshillit nuk ka vendosë tashmë sa i përket përmbajtjes së këtij vendimi pasi i njëjti siç u tha më lartë nuk ka fuqi ligjore nga se tashmë është i shfuqizuar nga organi i njëjtë që e ka nxjerrë, dhe po ashtu nuk është lëshuar në vlerësim të ligjshmërisë së vendimit që e ka shfuqizuar të njëjtin, nga se nuk ndërlidhet me këtë proces të regrutimit.

Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitivin e këtij vendimi, dhe nuk u lëshue në çështje tjera që nuk reflektohen në ndonjë ndryshim të vendimmarrjes nga ajo që u vendosë në këtë vendim.

Kështu që pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda A.nr.1556/2025

Rushit Kajtazi

Procesmbajtës

Eshref Shabani

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit V.H;
- Njësisë së Burimeve Njerëzore në Inspektoratin e Punës; si dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.